



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Nr. 250/3 prot.

Tiranë, më 26.05.2023

**NJOFTIM ME SHPALLJE**

**TË VENDIMIT NR. 250/1, DATË 15.05.2023 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS SË PARAQITUR NGA SHTETASI Z. ALEKS SHTJEFNI"**

Inspektori i Lartë të Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e z. Aleks Shtjefni me nr. 2996 prot., datë 14.12.2020, ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratit z. I.P., gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe me vendimin nr. 250/1, datë 15.05.2023 të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Aleks Shtjefni", bazuar në nenet 120, pika 1, shkronjat d), dh), 121, pika 2, shkronja a) të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin e ankesës. Vendim duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e komunikuar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:

- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Lëzhë, sipas adresës së lënë nga ankuesi: Fshati Gramsh, Lezhë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: [www.ild.al](http://www.ild.al).

Shpalljet që do të afishohen në ambientin e bashkisë përkatëse, do të hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**

